

VENDIM
Nr. 38, datë 7.5.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Genti Ibrahim	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 7.5.2024, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 53 (A) 2023 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Adem Rrenga

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Ministria e Brendshme, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, Avokatura e Shtetit

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-3127(267), datë 13.7.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, pika 1, 15, pika 2, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “I”, 142, pika 1 dhe 145, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 41, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 71 dhe 71/a, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahim, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e parashtrimeve të subjekteve të interesuara, Ministrisë së Brendshme, Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara dhe Avokaturës së Shtetit, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shtetasi Adem Rrenga (*kërkuesi*) prej datës 22.6.2012 deri në datën 9.1.2014, ka punuar në pozicionin e drejtorit në Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, i cili asokohe ka qenë institucion në varësi të Ministrisë së Financave. Marrëdhënia e punës ka qenë me afat të pacaktuar. Ministri i Financave, me urdhrin nr. 2, datë 6.1.2014, ka urdhëruar lirimin e menjëhershëm nga detyra të kërkuarit, ndërkohë që marrëdhëniet financiare me të janë ndërprerë në datën 9.1.2014.

2. Pas konsumimit të rrugëve administrative të ankimit brenda Ministrisë së Financave, në datën 28.3.2014, kërkuesi ka paraqitur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë kërkesëpadi me objekt shfuqizimin e urdhrit për lirim të tij nga detyra, rikthimin e tij në punë dhe shpërblimin për kohën e qëndrimit pa punë në bazë të ligjit nr. 152/2013, “Për statusin e nëpunësit civil”, të ndryshuar (*ligji nr. 152/2013*). Ai ka pretenduar se statusin e nëpunësit civil e ka fituar në datën 1.10.2013, pasi ish-pozicioni i tij i punës parashikohej në ato pozicione pune që gëzonin statusin e nëpunësit civil.

3. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të kërkesëpadisë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 1899, datë 25.4.2014, ka vendosur rrëzimin e saj si të pabazuar në ligj dhe në prova, me arsyetimin se, në rastin konkret, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi, zbatohet Kodi i Punës dhe jo ligji nr. 152/2013. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

4. Gjykata Administrative e Apelit, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 2474, datë 14.9.2016, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke pranuar pjesërisht kërkesëpadinë. Ajo ka vendosur detyrimin e palës së paditur, Ministrisë së Financave, t’i paguajë kërkuesit 1 (një) muaj pagë si dëmshpërblim për zgjidhjen e kontratës së punës pa respektuar afatin e njoftimit dhe 2 (dy) muaj pagë për zgjidhjen e kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustificuar. Kundër këtij vendimi, në datën 12.10.2016, kërkuesi ka ushtruar rekurs. Në vijim, në datën 1.11.2016, kundër vendimit të gjykatës së apelit ka ushtruar rekurs edhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-3127 (267), datë 13.7.2023, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me arsyetimin se me vendimin e saj Gjykata Administrative e Apelit ka kapërcyer kufijtë e padisë, duke u shprehur tej kërtimeve të ngritura nga paditësi. Po kështu, sipas Kolegjit Administrativ, gjykata e apelit nuk ka zbatuar drejt përfundimet e vendimit unifikues nr. 3, datë 29.3.2012, të Kolegeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

6. Në datën 3.11.2023, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pasi është plotësuar me dokumentet e kërkuara, bazuar në nenin 27, të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 7.11.2023. Me vendimin e datës 30.1.2024, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

7. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

7.1 *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në drejtim të:

7.1.1 *Së drejtës së aksesit në gjykatë*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, përmes vendimit të tij i ka shteruar kërkuesit të drejtën për t’u dëmshpërblyer për veprimet e padrejta të kryera nga pala e paditur, e cila i ka zgjidhur marrëdhëniet e punës pa shkak. Vendimi i Gjykatës së Lartë është përfundimtar dhe çështja përbën gjë të gjykuar, ndërkohë që mosmarrëveshja nuk ka marrë zgjidhje. Shkaku ligjor përmes të cilit ai ka vënë në lëvizje gjykatën ka qenë zgjidhja në mënyrë të njëanshme dhe pa shkak e marrëdhënieve të punës nga ana e punëdhënësit. Shkaku ligjor evidentohet nga përmbajtja e padisë, pavarësisht dispozitës së cituar nga kërkuesi. Legjislacioni shqiptar i përket së drejtës pozitive, ndaj forma e aktit nuk mund t’i kundërvihet përmbajtjes. Lënda e kërkesëpadisë është themeli, pra zgjidhja e marrëdhënieve të punës në mënyrë të kundërligjshme nga punëdhënësi, ndërsa forma është mënyra se si do të detyrohet pala që është me faj të dëmshpërblejë punëmarrësin.

7.1.2 *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë është alogjik në raport me provat dhe qëndrimin që ka mbajtur Gjykata Administrative e Apelit. Në rekurs është kërkuar zgjidhja në mënyrë shteruese nga ky kolegji të kërkesës për dëmshpërblim për zgjidhjen e marrëdhënies së punës sipas dispozitave të ligjit nr. 152/2013, si dhe kërkesës alternative për dëmshpërblim sipas dispozitave të Kodit të Punës, të cilave u ka dhënë përgjigje shteruese gjatë gjykimit vetëm Gjykata Administrative e Apelit. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk e kundërshton faktin që pala e paditur e ka marrë vendimin për largimin nga puna në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkak, por arsyeton se nuk janë përdorur mjetet e duhura procedurale për ta kërkuar këtë të drejtë, pasi e drejta për t'u dëmshpërblyer duhet të trajtohet, duke e konsideruar kërkuuesin jo si person të punësuar sipas ligjit nr. 152/2013, por sipas dispozitave të Kodit të Punës. Gjykata e Lartë, sikurse Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë nuk mund të dispononin me vendim për rrëzimin e padisë, pavarësisht nëse ky qëndrim është ose jo i drejtë, por me vendim për pushimin e gjykimit për të mos shteruar të drejtën e kërkuarit për ngritjen e padisë. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vepruar me standarde të dyfishta, pasi vendimi i tij është në kundërshtim me standardet e vendosura me vendimin unifikues nr. 3, datë 29.3.2012, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (*vendimi unifikues nr. 3/2012, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*). Gjykata e Lartë nuk mund të justifikojë gjykimin vetëm nga ana formale pa i hyrë thellë, provave dhe ligjit.

7.2 *E drejta për t'u rehabilituar dhe/ose zhëdmtuar në përputhje me ligjin*, e garantuar nga neni 44 i Kushtetutës, pasi vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është rrjedhojë e një procesi të parregullt gjyqësor dhe përmes tij kërkuarit i është shteruar e drejta për t'u dëmshpërblyer për veprimet e padrejta të kryera nga punëdhënësi, i cili ka zgjidhur marrëdhëniet e punës pa shkak.

8. Subjektet e interesuara, Ministria e Brendshme, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, si dhe Avokatura e Shtetit, nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim, megjithëse janë njoftuar rregullisht.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatën e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

10. Gjykata vlerëson se kërkuari, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, në të cilin është dhënë vendimi i kundërshtuar, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuari i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk ka mjet

tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual.

12. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000, ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se procesi gjyqësor është përmbyllur me vendimin nr. 00-2023-3127(267), datë 13.7.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 3.11.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000. Si rrjedhim, Gjykata vlerëson se kërkuksi legjitimohet edhe *ratione temporis*.

13. Në drejtim me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuksi ka pretenduar se gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Lartë i janë cenuar disa të drejta dhe parime kushtetuese, duke parashtruar, si të tilla, të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit në gjykatë dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, si dhe të drejtën për t’u rehabilituar dhe/ose zhdëmtuar në përputhje me ligjin, të garantuar nga neni 44 i Kushtetutës.

14. Duke pasur parasysh thelbin e pretendimeve të parashtruara nga kërkuksi në ankimin kushtetues individual, Gjykata çmon se pretendimet për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor t’i shqyrtojë në drejtim të së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Ndërkohë, duke mbajtur në konsideratë se argumentet e kërkuksit për cenimin e së drejtës për t’u rehabilituar dhe/ose zhdëmtuar në përputhje me ligjin kanë të bëjnë në mënyrë të drejtpërdrejtë me procesin gjyqësor të kundërshtuar, Gjykata vlerëson se ky pretendim duhet të shqyrtohet në këndvështrim të së drejtës për proces të rregullt ligjor.

15. Për sa më lart, Gjykata çmon të shqyrtojë në vijim bazueshmërinë në themel të pretendimeve të kërkuksit për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

16. Kërkuksi ka pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, përmes vendimit të tij, i ka hequr kërkuksit të drejtën për t’u dëmshpërblyer për veprimet e padrejta të kryera nga pala e paditur, e cila i ka zgjidhur marrëdhëniet e punës pa shkak. Vendimi i Gjykatës së Lartë është përfundimtar dhe çështja përbën gjë të gjykuar, ndërkohë që mosmarrëveshja nuk ka marrë zgjidhje. Shkaku ligjor, mbi bazën e të cilit kërkuksi ka vënë në lëvizje gjykatën, ka qenë zgjidhja në mënyrë të njëanshme dhe pa shkak të marrëdhënieve të punës nga ana e palës së paditur, që përbën themelin e padisë. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë është alogjik në raport me provat dhe qëndrimin që ka mbajtur Gjykata Administrative e Apelit. Në rekurs është kërkuar zgjidhja në mënyrë shteruese nga ky kolegji të kërkesës për dëmshpërblim për zgjidhjen e marrëdhënies së punës sipas dispozitave të ligjit për nëpunësin civil, si dhe kërkesës alternative për dëmshpërblim sipas dispozitave të Kodit të Punës, të cilave u ka dhënë përgjigje shteruese gjatë gjykimit vetëm Gjykata Administrative e Apelit. Gjykata e Lartë, sikurse Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë nuk mund të dispononin me vendim për rrëzimin e padisë, pavarësisht nëse ky qëndrim është ose jo i drejtë, por me vendim për pushimin e gjykimit për të mos shteruar të drejtën e kërkuksit për ngritjen e padisë. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vepruar me standarde të dyfishta, pasi vendimi i tij është në kundërshtim me standardet e vendosura me vendimin unifikues nr. 3/2012, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

17. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t’i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për

të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesimi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 32, datë 3.11.2022; nr. 6, datë 22.2.2022; nr. 5, datë 22.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykata ka theksuar se e drejta për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar përkon me detyrimin e gjykatave për të arsyetuar vendimet, sipas nenit 142, pika 1, të Kushtetutës. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje dhe në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Ndërsa në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 18, datë 15.3.2016; nr. 8, datë 28.2.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata vëren se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së paraqitur nga kërkuesi, duke arsyetuar, në mënyrë të përmbledhur, se ndonëse pozicioni i punës së kërkuarit përfshihej në kategorinë e nëpunësit civil, ai nuk e ka gëzuar këtë status, pasi nuk është rekrutuar në bazë të dispozitave të ligjit të kohës, përkatësisht ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, "Statusi i nëpunësit civil", të ndryshuar. Në këto kushte, ajo ka vlerësuar se padia ishte e pabazuar në ligj, pasi ligji i zbatueshëm në kohën e largimit nga puna të kërkuarit ishte Kodi i Punës dhe jo ligji nr. 152/2013 (*shih faqet 5 dhe 7, të vendimit nr. 1899, datë 25.4.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë*).

20. Gjykata konstaton se Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke pranuar pjesërisht kërkesëpadinë. Ajo ka vendosur detyrimin e palës së paditur, Ministrisë së Financave, t'i paguajë kërkuarit 1 (një) muaj pagë si dëmshpërblim për zgjidhjen e kontratës së punës pa respektuar afatin e njoftimit dhe 2 (dy) muaj pagë për zgjidhjen e kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustificuar, duke arsyetuar se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është rrjedhojë e një analize të drejtë lidhur me aplikimin e ligjit për statusin e nëpunësit civil dhe një analize jo të drejtë të provave për zgjidhjen e pasojave të marrëdhënieve të punës. Sipas gjykatës së apelit, kërkuesi nuk është rekrutuar sipas dispozitave ligjore të statusit të nëpunësit civil dhe, për rrjedhojë, nuk e ka gëzuar statusin përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, si dhe ky status nuk mund të fitohet automatikisht, por duhet të konfirmohet nga njësia kompetente pranë organit, gjë e cila, në rastin konkret, nuk ka ndodhur. Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar se i takonte asaj të zbulonte shkakun ligjor të padisë që, referuar tërësisë së rrethanave, rezultonte të ishte zgjidhja e marrëdhënieve të punës pa shkaqe të arsyeshme. Me këtë arsyetim ajo ka vlerësuar se për zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi zbatohet Kodi i Punës dhe se punëdhënësi e ka larguar punëmarrësin pa të drejtë, në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkaqe të justifikuara (*shih faqet 3 dhe 11, të vendimit nr. 2474, datë 14.9.2016, të Gjykatës Administrative të Apelit*).

21. Për sa i takon procesit në Gjykatën e Lartë, Kolegji Administrativ i saj ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke arsyetuar, në mënyrë të përmbledhur, se arsyetimi dhe

përfundimi i arritur nga Gjykata Administrative e Apelit është rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit procedural, duke vlerësuar paraprakisht se përfundimi i arritur nga të dyja gjykatat e faktit se kërkuesi nuk ka qenë nëpunës civil sipas ligjit nr. 152/2013 *(dhe atij pararendës)* dhe se ai nuk gëzonte asnjë të drejtë të këtij statusi, është i drejtë dhe i bazuar në ligj. Kolegji Administrativ nuk ka mbështetur zgjedhjen e gjykatës së apelit, e cila ka vijuar gjykimin duke zgjidhur një mosmarrëveshje tjetër nga ajo e paraqitur për gjykim, bazuar në një shkak tjetër ligjor të papretenduar nga kërkuesi, sipas të drejtave që rrjedhin nga Kodi i Punës dhe ka dhënë dëshmipërblime sipas neneve 143 dhe 155 të këtij kodi, të pakërkuara në padi, duke mos pasur parasysh orientimet e dhëna me vendimin unifikues nr. 3/2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Sipas Kolegjit Administrativ, gjykata e apelit nuk mund të ndryshonte kryesisht objektin dhe shkakun e padisë së tij, pasi kjo është e drejtë ekskluzive e kërkuetit, i cili në ankim ka mbajtur të njëjtin qëndrim dhe kërkim, duke kërkuar zgjidhjen e pasojave në zbatim të ligjit nr. 152/2013 dhe jo të Kodit të Punës. Ajo nuk mund të shprehej tej kërtimeve në padi dhe në ankimin e paraqitur, për më tepër kur në këtë çështje nuk rezulton që kërkuesi të ketë bërë kërkesë për shtim, saktësim ose ndryshim të objektit të padisë apo shkakut të saj. Sipas tij, ndonëse përgatitja, gjykimi dhe zgjidhja e çështjes nuk mund të bazohen vetëm mbi atë që formalisht shkruhet në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë e që emërtohen “objekti i padisë” dhe “baza ligjore” e saj, përsëri gjykata ka detyrimin të shprehet vetëm për atë që kërkohet nga kërkuesi *(shih paragrafët 15, 17, 19 dhe 20, të vendimit nr. 00-2023-3127 (267), datë 13.7.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë)*.

22. Gjykata vëren se pika kryesore e pretendimit kushtetues të kërkuetit ka të bëjë me mënyrën se si Gjykata e Lartë në vendimin e saj ka interpretuar konceptet ligjore procedurale të objektit dhe shkakut ligjor të padisë, të bazës ligjore të padisë dhe të së drejtës së gjykatës së zakonshme për të bërë me nismën e saj cilësimin ligjor të mosmarrëveshjes që i paraqitet për shqyrtim, të rregulluara nga nenet 5, 31, 154 e 185 të Kodit të Procedurës Civile dhe vendimi unifikues nr. 3/2012. Duke iu referuar arsytimit të Gjykatës së Lartë, Gjykata thekson se ajo ka vepruar brenda funksionit të saj kushtetues për interpretimin e ligjit, duke i dhënë përgjigje të argumentuar kërkuetit për pretendimet e tij të parashtruara në rekurs në respektim të së drejtës së aksesit në gjykatë. Arsyetimi i saj për përfundimin e arritur për kërkimin e kërkuetit nuk rezulton i pamjaftueshëm, pasi ai nuk përmban kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë dhe as të meta të tilla serioze që të cenojnë standardin kushtetues të vendimit gjyqësor të arsyetuar.

23. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuetit për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor nuk janë të bazuara, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 7.5.2024.

Shpallur, më 6.6.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Elsa Toska, Marjana Semini, Ilir Toska

Anëtar kundër: Sonila Bejtja, Genti Ibrahim

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes nr. 53 (A) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket kërkuessit Adem Rrenga, me objekt: *“Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-3127(267), datë 13.7.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtuesshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”*, jemi kundër qëndrimit të shumicës, e cila ka rrëzuar kërkesën e tij dhe në vlerësimin tonë kërkesa e tij duhej pranuar. Për këtë arsye, çmojmë të shprehemi me mendim pakice.

2. Duke iu kthyer rastit objekt shqyrtimi, vërehet se kërkuessi ka paraqitur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë kërkesëpadi me objekt shfuqizimin e urdhrin për lirimin e tij nga detyra, rikthimin e tij në punë dhe shpërbimin për kohën e qëndrimit pa punë në bazë të ligjit nr. 152/2013, “Për statusin e nëpunësit civil”, të ndryshuar (*ligji nr. 152/2013*). Ai ka pretenduar se statusin e nëpunësit civil e ka fituar në datën 1.10.2013, pasi ish-pozicioni i tij i punës parashikohej në ato pozicione pune që gëzonin këtë status. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së paraqitur nga kërkuessi, duke arsyetuar, në mënyrë të përmbledhur, se ndonëse pozicioni i punës së tij përfshihej në kategorinë e nëpunësit civil, ai nuk e ka gëzuar këtë status, pasi nuk ishte rekrutuar në bazë të dispozitave të ligjit të kohës, përkatësisht ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, të ndryshuar. Në këto kushte, gjykata ka vlerësuar se padia ishte e pabazuar në ligj, pasi ligji i zbatueshëm në kohën e largimit nga puna të kërkuessit ishte Kodi i Punës dhe jo ligji nr. 152/2013 (*shih faqet 5 dhe 7, të vendimit nr. 1899, datë 25.4.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë*).

3. Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke pranuar pjesërisht kërkesëpadinë. Ajo ka vendosur detyrimin e palës së paditur, Ministrisë së Financave, t’i paguajë kërkuessit 1 (një) muaj pagë si dëmshpërbim për zgjidhjen e kontratës së punës pa respektuar afatin e njoftimit dhe 2 (dy) muaj pagë për zgjidhjen e kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustificuar, duke arsyetuar se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është rrjedhojë e një analize të drejtë lidhur me aplikimin e ligjit për statusin e nëpunësit civil dhe një analize jo të drejtë të provave për zgjidhjen e pasojave të marrëdhënieve të punës. Sipas gjykatës së apelit, kërkuessi nuk është rekrutuar sipas dispozitave ligjore të statusit të nëpunësit civil dhe, për rrjedhojë, nuk e ka gëzuar statusin përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, si dhe ky status nuk mund të fitohet automatikisht, por duhet të konfirmohet nga njësi kompetente pranë organit, gjë e cila, në rastin konkret, nuk ka ndodhur. Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar se i takonte asaj të zbulonte shkakun ligjor të padisë që, referuar tërësisë së rrethanave, rezultonte të ishte zgjidhja e marrëdhënieve të punës pa shkaqe të arsyeshme. Me këtë arsyetim ajo ka vlerësuar se për zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi zbatohet Kodi i Punës dhe se punëdhënësi e ka larguar punëmarrësin pa të drejtë, në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkaqe të justifikuara (*shih faqet 3 dhe 11, të vendimit nr. 2474, datë 14.9.2016, të Gjykatës Administrative të Apelit*).

4. Pas shqyrtimi të rekursit të ushtruar nga kërkuessi, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i saj ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke arsyetuar, në mënyrë të përmbledhur, se arsyetimi dhe përfundimi i arritur nga Gjykata Administrative e Apelit është rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit të gabuar të ligjit procedural, duke vlerësuar paraprakisht se përfundimi i arritur nga të dyja gjykatat e faktit se kërkuessi nuk ka qenë nëpunës civil sipas ligjit nr. 152/2013 (*dhe atij pararendës*) dhe se ai nuk gëzonte asnjë të drejtë të këtij statusi, është i drejtë dhe i bazuar në ligj. Kolegji

Administrativ nuk ka mbështetur zgjedhjen e gjykatës së apelit, e cila ka vijuar gjykimin duke zgjidhur një mosmarrëveshje tjetër nga ajo e paraqitur për gjykim, bazuar në një shkak tjetër ligjor të papretenduar nga kërkuesi, sipas të drejtave që rrjedhin nga Kodi i Punës dhe ka dhënë dëmshpërblime sipas neneve 143 dhe 155 të këtij kodi, të pakërkuara në padi, duke mos pasur parasysh orientimet e dhëna me vendimin unifikues nr. 3/2012 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Sipas Kolegjit Administrativ, gjykata e apelit nuk mund të ndryshonte kryesisht objektin dhe shkakun e padisë së tij, pasi kjo është e drejtë ekskluzive e kërkuesit, i cili në ankim ka mbajtur të njëjtin qëndrim dhe kërkim, duke kërkuar zgjidhjen e pasojave në zbatim të ligjit nr. 152/2013 dhe jo të Kodit të Punës. Ajo nuk mund të shprehej tej kërkimeve në padi dhe në ankimin e paraqitur, për më tepër kur në këtë çështje nuk rezulton që kërkuesi të ketë bërë kërkesë për shtim, saktësim ose ndryshim të objektit të padisë ose shkakut të saj. Sipas tij, ndonëse përgatitja, gjykimi dhe zgjidhja e çështjes nuk mund të bazohen vetëm mbi atë që formalisht shkruhet në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë e që emërtohen “objekti i padisë” dhe “baza ligjore” e saj, përsëri gjykata ka detyrimin të shprehet vetëm për atë që kërkohet nga kërkuesi (*shih paragrafët 15, 17, 19 dhe 20, të vendimit nr. 00-2023-3127 (267), datë 13.7.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

5. Kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual, duke pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të aksesit në gjykatë dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, me argumentet se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, përmes vendimit të tij i ka hequr atij të drejtën për t'u dëmshpërblyer për veprimet e padrejta të kryera nga pala e paditur, e cila i ka zgjidhur marrëdhëniet e punës pa shkak. Sipas kërkuesit, vendimi i Gjykatës së Lartë, përmes të cilit është lënë në fuqi vendimi i gjykatës së shkallës së parë, është përfundimtar dhe çështja përbën gjë të gjykuar, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së lartë e ka zgjidhur çështjen në themel, ndërkohë që mosmarrëveshja nuk ka marrë zgjidhje. Shkaku ligjor, mbi bazën e të cilit kërkuesi ka vënë në lëvizje gjykatën, ka qenë zgjidhja në mënyrë të njëanshme dhe pa shkak të marrëdhënieve të punës nga ana e palës së paditur, që përbën themelin e padisë. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë është alogjik në raport me provat dhe qëndrimin që ka mbajtur Gjykata Administrative e Apelit. Sipas kërkuesit, në rekurs është kërkuar zgjidhja në mënyrë shteruese nga ky kolegji të kërkesës për dëmshpërblim për zgjidhjen e marrëdhënies së punës sipas dispozitave të ligjit për nëpunësin civil, si dhe kërkesës alternative për dëmshpërblim sipas dispozitave të Kodit të Punës, të cilave u ka dhënë përgjigje shteruese gjatë gjykimit vetëm Gjykata Administrative e Apelit. Gjykata e Lartë, sikurse Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë nuk mund të dispononin me vendim për rrëzimin e padisë, pavarësisht nëse ky qëndrim është ose jo i drejtë, por me vendim për pushimin e gjykimit për të mos shteruar të drejtën e kërkuesit për ngritjes së padisë (*shih paragrafët 15 dhe 16 të vendimit*).

6. Pretendimi i kërkuesit është analizuar nga shumica në këndvështrimin e së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor dhe në përfundim është vlerësuar se pretendimi është i pabazuar (*shih paragrafin 23 të vendimit*). Sipas shumicës, pika kryesore e pretendimit kushtetues të kërkuesit ka të bëjë me mënyrën se si Gjykata e Lartë, në vendimin e saj, ka interpretuar konceptet ligjore procedurale të objektit dhe shkakut ligjor të padisë, të bazës ligjore të padisë dhe të së drejtës së gjykatës së zakonshme për të bërë me nismën e saj cilësimin ligjor të mosmarrëveshjes që i paraqitet për shqyrtim, të rregulluara nga nenet 5, 31, 154 e 185 të KPC-së dhe vendimi unifikues nr. 3/2012 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Duke iu referuar arsytimit të Gjykatës së Lartë, Gjykata thekson se ajo ka vepruar brenda funksionit të saj kushtetues për interpretimin e ligjit, duke i dhënë përgjigje të argumentuar kërkuesit për pretendimet e tij të parashtruara në rekurs në respektim të së drejtës së aksesit në gjykatë. Arsytimi i saj, në lidhje me përfundimin e arritur për kërkimin e kërkuesit, nuk rezulton i pamjaftueshëm, ai nuk përmban kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë dhe as të meta të tilla serioze që të cenojnë standardin kushtetues të vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih paragrafin 22 të vendimit*).

7. Në ndryshim nga shumica, ne, gjyqtarët në pakicë, çmojmë se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor të Gjykatës së Lartë është i bazuar.

8. Në nenin 42, pika 2, të Kushtetutës parashikohet, ndër të tjera, se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e gjykimit të çështjes së tij/saj nga një gjykatë.

9. E drejta e aksesit i garanton individit t'i drejtohet një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tij/saj dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Kjo e drejtë nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 31, datë 3.11.2022; nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Nëse mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, përpara së gjithash, kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimet nr. 26, datë 9.4.2024; nr. 22, datë 25.4.2023; nr. 14, datë 21.3.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Po kështu, Gjykata ka theksuar se e drejta për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar përkon me detyrimin e gjykatave për të arsyetuar vendimet, sipas nenit 142, pika 1, të Kushtetutës. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje dhe në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar. Ndërsa në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 10, datë 4.3.2021; nr.18, datë 15.3.2016; nr. 8, datë 28.2.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Nga analiza e vendimeve gjyqësore, konstatohet se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë vlerësuar se kërkuar nuk e gëzonte statusin e nëpunësit civil dhe, si rrjedhim, marrëdhënia e tij e punës rregullohej nga dispozitat e Kodit të Punës. Pas këtij konstatimi, si dhe duke iu përmbajtur kërtimeve të kërkuarit në kërkesëpadi, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë nuk e ka shqyrtuar çështjen në themel për zgjidhjen e marrëdhënies së punës sipas Kodit të Punës. Ndërkohë që gjykata e apelit e ka gjykuar çështjen në themel, duke u dhënë zgjidhje pasojave të ardhura nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës, duke iu referuar parashikimit të dispozitave në Kodin e Punës. Qëndrimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë ka qenë i ndryshëm nga ai i gjykatës së apelit, pasi Kolegji Administrativ ka vlerësuar se gjykata e apelit ka zgjidhur një mosmarrëveshje tjetër nga ajo e paraqitur për gjykim, bazuar në një shkak tjetër ligjor të papretenduar nga kërkuar, sipas të drejtave që rrjedhin nga Kodi i Punës (*shih paragrafin 17, të vendimit nr. 00-2023-3127 (267), datë 13.7.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

12. Ndërkohë që vërehet se në përmbajtjen e rekursit nga ana e kërkuarit është kërkuar zgjidhja përfundimtare e çështjes përmes dy opsioneve të parashtruara nga ai, që përfshijnë zgjidhjen e çështjes përmes trajtimit të saj sipas legjislacionit për nëpunësin civil ose në bazë të Kodit të Punës. Në këtë kuptim, ai ka kërkuar nga Gjykata e Lartë: i. ndryshimin e vendimeve të gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së apelit për sa i përket shfuqizimit të urdhrit të ministrit të Financave për lirimin e tij nga detyra dhe rikthimin e tij në punë, si dhe shpërblimin për kohën e qëndrimit pa punë; ii. ndryshimin e pjesshëm të vendimit të gjykatës së apelit përmes pranimit të plotë të kërkesëpadisë, duke vendosur detyrimin e palës së paditur për t'i paguar e 1 (një) pagë mujore dëmshpërblim për zgjidhjen e kontratës

së punës pa respektuar afatin e njoftimit, 2 (dy) paga mujore dëmshpërblim për mosrespektim të procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës, si dhe 12 (dymbëdhjetë) paga mujore për zgjidhjen e kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustificuar.

13. Në dallim me vlerësimin e shumicës, ne, gjyqtarët në pakicë, jemi të mendimit se shumica e ka keqkuptuar thelbin e pretendimit të kërkuarit dhe, për pasojë, ka arritur në një përfundim të gabuar lidhur me të. Në thelb, kërkuari ka ngritur pretendimin se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i ka cenuar atij të drejtën e aksesit në gjykatë, pasi nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit të tij thelbësor, se ai ishte larguar nga puna në mënyrë të kundërligjshme nga punëdhënësi. Gjatë vendimmarrjes së tij, Kolegji Administrativ ka arsyetuar se kërkuari e ka ngritur pretendimin e tij bazuar në dispozitat e ligjit nr. 152/2013, duke pretenduar të drejta që nuk i takonin, në kushtet kur nuk e gëzonte statusin e nëpunësit civil. Në këtë kuptim, ky kolegji ka barazuar *shkakun e padisë* me *bazën ligjore* që zbatohet për gjykimin e padisë. Po kështu, Kolegji Administrativ ka arsyetuar se të drejtat e pretenduara nga kërkuari gjatë procesit gjyqësor në gjykatat e faktit rrjedhin nga statusi i nëpunësit civil dhe në vijim ka vlerësuar se në kushtet kur këto gjykata kanë mbajtur qëndrimin se ai nuk e gëzonte statusin e nëpunësit civil, nuk mund të pretendonte të drejta që lidhen me këtë status.

14. Për sa më lart, ne, gjyqtarët në pakicë, mendojmë se shkak i padisë lidhet gjithmonë me një të drejtë subjektive kushtetuese ose ligjore që pretendohet se është cenuar. E thënë ndryshe, e drejta që pretendohet se është cenuar përbën shkakun e padisë, qoftë kjo e thënë edhe në thelb të kërkitimit. Ndonëse ne pajtohemi me mendimin se disa të drejta ligjore rrjedhin nga statutet ligjore të individëve (*si për shembull të drejtat që rrjedhin nga statusi si nëpunës civil ose statusi si punonjës i Forcave të Armatosura*), ky arsyetim nuk vlen për të drejtat kushtetuese, siç është e drejta për një proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës. Nga këto të drejta kushtetuese përfitojnë të gjithë dhe pikërisht ky ka qenë në thelb pretendimi i kërkuarit, si përpara gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, ashtu edhe përpara Gjykatës.

15. Ndërsa kërkuari ka kërkuar gjyqësish përpara gjykatave të juridiksionit të zakonshëm zgjidhjen e pasojave që kanë ardhur si rezultat i largimit të tij nga puna, sipas tij pa shkak të ligjshëm, ai nuk ka bërë gjë tjetër veçse ka evokuar të drejtën e tij kushtetuese për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës. Në këtë kuptim, ai ka pretenduar se punëdhënësi i ka cenuar të drejtën e njohur nga ligji nr. 152/2013, për të mos u larguar nga puna pa shkaqe të ligjshme. Me fjalë të tjera, në thelb të padisë së kërkuarit ka qenë ndërprerja pa shkak të ligjshëm e marrëdhënieve të punës nga punëdhënësi, pavarësisht ligjit që e rregullonte marrëdhënien e tij të punës me punëdhënësin e tij.

16. Për sa më lart, ne, gjyqtarët në pakicë, vlerësojmë se e drejta për të mos u larguar nga puna pa shkaqe të ligjshme iu garantohet të gjithë të punësuarve, pavarësisht legjislacionit që rregullon marrëdhënien e punës ose statusit që ata përfitojnë prej tij. E drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, kupton detyrimin e gjykatave për t'u dhënë përgjigje pretendimeve të individëve edhe lidhur me të drejtën për të mos u larguar nga puna pa shkaqe të ligjshme, duke iu garantuar atyre akses të plotë e thelbësor në gjykatë.

17. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk mund të tregohen formaliste duke lënë pa përgjigje pretendime thelbësore nisur thjesht dhe vetëm nga fakti se paditësit nuk kanë identifikuar saktë bazën ligjore ku mbështesin pretendimet e tyre. Siç ka arsyetuar edhe kërkuari, sistemi ynë ligjor i përket “familjes” së sistemeve ligjore kontinentale/pozitive ku gjykatat, në zbatim të doktrinës *iura novit curia* kanë autoritetin, madje detyrimin, që me nismën e tyre të bëjnë cilësimin ligjor të mosmarrëveshjes që paraqitet për shqyrtim përpara tyre duke u dhënë në çdo rast përgjigje pretendimeve thelbësore të paditësve pa u lidhur me referencat dhe cilësimet ligjore të zgjedhura nga ata.

18. Në këndvështrim të sa më lart, ne, gjyqtarët në pakicë, mendojmë se qëndrimi i Gjykatës së Lartë është i bazuar në një arsyetim formalist, duke bërë një interpretim të ngushtë të së drejtës së aksesit, që nuk përputhet me kuptimin e qëllimit të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

Në këtë drejtim, edhe GJEDNJ-ja është shprehur se interpretimi i ngushtë i së drejtës së aksesit, që garantohet nga neni 6, paragrafi 1, i KEDNJ-së, nuk është në përputhje me objektin dhe qëllimin e këtij parashikimi. Rëndësia e ushtrimit të të drejtave procedurale ndryshon në varësi të qëllimit të veprimeve, të cilat personi në fjalë synon t'i ushtrojë përpara gjykatave (*shih Nataliya Mikheylenko kundër Ukrainës, aplikimi nr. 49069/11, datë 30.5.2013, §37*). Duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, Gjykata e Lartë ia ka bërë të pamundur kërkuesit një kërkim tjetër të ri të tij, qoftë edhe nëpërmjet një padie të re me baze ligjore sipas trajtimit të gjykatës.

19. Në përfundim, ne, gjyqtarët në pakicë, çmojmë se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor ishte i bazuar, ndaj ankimi kushtetues individual i tij duhej të pranohej dhe të vendosej shfuqizimi i vendimit të Gjykatës së Lartë.

Anëtarë: Genti Ibrahim, Sonila Bejtja